



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2363/ 6 prot.

Datë 10.09.2024

V E N D I M
Nr. 1221 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.09.2024 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastër.

Ankimues: Operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F me Nipt. L42103023G dhe adresë: *Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokastër
Adresa: Gjirokastër

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.07.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.

II.2. Në datën 18.07.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 06.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MURATI D” SHPK	me ofertë	2,155,872	lekë	Skualifikuar
2. “BESIM KAMBERII” PF	“	2,399,125	“	Skualifikuar

3.	“SOFIA MYFTARI” PF	“	2,462,565	“	Skualifikuar
4.	“MIFEEL” SHPK	“	2,770,584	“	Skualifikuar
5.	“ATLANTIK 3” SHPK	“	2,782,435	“	Skualifikuar

II.4. Autoriteti kontraktor më datë 15.08.2024 ka publikuar Anulimin e Procedurës.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. aplikimi elektronik A/2024/4480 datë 21.08.2024 dhe me nr. 2363/2024 prot, datë 21.08.2024, e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” PF, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 dhe 4/b të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2363/2 prot., datë 22.08.2024, u publikuan arsyet e skualifikimit:

“Nuk plotesoni kriterin e DST-se Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofertojnë sipas kodeve përkatëse në preventiv. Në të kundërt përbën shkak për skualifikim

- OE kalon fondin limit për kodin V923AAD 141,620.00
- OE kalon fondin limit për kodin V424AAB 28230.00”.

II.7. Autoriteti kontraktor me shkresën nr.7477 prot., datë 26.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 2363/3, datë 28.08.2024, me objekt “Kthim përgjigje ankesës”, me anë të së cilës ka trajtuar ankesën, informon se ka vendosur mospranim të saj.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BESIM KAMBERII” PF, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen:

“Nuk plotësoni kriterin e DST-së Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofertojnë sipas kodeve përkatëse në preventiv. Në të kundërt përbën shkak për skualifikim

- *OE kalon fondin limit për kodin V923AAD 141,620.00*
- *OE kalon fondin limit për kodin V424AAB 28230.00”.*

III.1.1. **Në nenin 12**, pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet se:

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit.

Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit.

III. 1.2 **Neni 29** *“Oferta ekonomike”* e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

III.1.3. **Në nenin 82** *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.4. Referuar DST -Autoriteti kontraktor ka publikuar :

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Materiale pastrimi”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve)_ Ref 09621-06-18-2024

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)_ klor 24311900-6 fshesa 39224100-9

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje	Marrje me qira	Blerje me këste	Një kombinim i këtyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po Jo

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **3.051.490 (tre milion e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë) leke pa t.v.sh**
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____**
3. Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

6 Çmimet

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit..
2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasisë dhe çmimin e tyre.
3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimit midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

10 Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

11 Paraqitja e Ofertave

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.

III.1.4.1. Shtojca 1 , 1/1 dhe 2 të DST

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim me te ulet]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me

Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

SQARIM

Operatori ekonomik fitues do të dorëzojë mallrat të ndarë sipas sasive përkatëse të kodeve buxhetore nëpër drejtoritë përkatëse.

KUJDES

V111AAD	782,350.00
V912AAB	333,260.00
V923AAB	599,700.00
V923AAD	141,620.00
V510AAD	604,230.00
V510AAC	227,400.00
V328AAC	85,570.00
V822AAC	124,490.00
V823AAB	124,640.00
V424AAB	28,230.00

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofertojnë sipas kodeve përkatëse në preventiv. Në të kundërt përbën shkak për skualifikim.

III.1.5. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se operatori ekonomik “BESIM KAMBERI P.F, në përmbushje të kërkesave në DST, ka paraqitur formularin e ofertës në formën si më poshtë vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data: 18.07.2024

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-09621-06-18-2024

Për: [Bashkia Gjirokastër]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [BESIM KAMBERI PF, L42103023G]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

(a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[“Materiale pastrimi”], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

(b) Ne [BESIM KAMBERI PF, L42103023G, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me

kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [“Materiale pastrimi”]

(c) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [Bashkia Gjirokastrë], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [24311900-639224100-9] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

2. Njoftimin e Kontratës;

3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar; 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Listat e Çmimeve të Artikujve. (e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 2 399 125 [Dy milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e pesë] lekë;

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 2 878 950 [Dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë] lekë;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Besim KAMBERI

Nënshkrimi Vula

Datë 18.07.2024.

III.1.6. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kërkesave dhe kushteve për t’u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e vendosura. Referuar legjislacionit, autoriteti kontraktor si subjekt përgjegjës për prokurimet, përcakton fondin limit në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tij për blerje mallra, në rastin konkret për objektin e prokurimit “Blerje materiale pastrimi” ka përcaktuar fondin limit 3.051.490 L pa TVSh, si dhe listën e mallrave me sasinë e përcaktuara.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Në plotësimin e dokumentacionit të ofertës, operatorët ekonomikë duhet t’i përmbahen me rigorozi të kërkesave të publikuara në DST duke plotësuar të gjitha dokumentet standarde siç ato janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor, si dhe janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka plotësuar Formularin e ofertës sipas **Shtojcës 1**, pjesë e DST

Formulari i ofertës,

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 2 399 125 [Dy milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e pesë] lekë;

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 2 878 950 [Dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë] lekë;

Shtojca 2, LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE ,

operatori ka plotësuar tabelën me artikujt në sasi të e kërkuara, çmime për njësi, çmime total për artikuj, çmim total të ofertës pa TVSh dhe çmim total të ofertë me TVSh.

Referuar nenit 12, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku përcaktohet “Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t’i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit”, gjithashtu në nenin 29 “Oferta ekonomike” e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht: 1.Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH”, Komisioni gjykon, se tejkalimi i fondit limit për kod, sipas arsyes së skualifikimit:

“Nuk plotësoni kriterin e DST-se Operatoret ekonomik pjesëmarrës duhet të ofertojnë sipas kodeve përkatëse në preventiv. Në të kundërt përbën shkak për skualifikim

- *OE kalon fondin limit për kodin V923AAD 141,620.00*

- *OE kalon fondin limit për kodin V424AAB 28230.00*”, i operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F, nuk ndikon në vlerën totale të ofertës së dorëzuar nga ankimuesi.

Referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, vlera e parashikuar e prokurimit bazohet në shumën totale pa TVSh, dhe oferta ekonomike e dorëzuar nga operatori ekonomik përmban vlerën ekonomike pa TVSH, çka konstatohet se nuk tejkalon fondin limit të përcaktuar, apo të ketë gabime aritmetike.

Referuar dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor me vendosjen e fondit limit dhe ndarjen në kode, ka komplikuar punën e operatorëve ekonomikë si edhe të KVO-së në kryerjen e vlerësimeve të ofertave.

Akoma më tej, referuar DST-së, AK ka bashkëlidhur dokumentin preventiv, Komisioni vëren se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kode që i përkasin disa institucioneve të varësisë në Bashkinë Gjirokastrë, me qëllim shpërndarjen e mallrave objekt - prokurimi, çka nuk ka lidhje me plotësimin e formularëve të ofertave nga operatorët ekonomikë kur kjo procedurë prokurimi nuk është marrëveshje kuadër.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë duhet të ofertojnë në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe shtojcat përkatëse, në rastim konkret nga shqyrtimi i ofertës

ekonomike të operatorit ankimues, konstatohet, se oferta ekonomike, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton e rregullt.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BESIM KAMBERI” P.F qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-09621-06-18-2024, me objekt: “Materiale Pastrimi”, me fond limit 3,051,490 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.07.2024, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi Skualifikimin e operatorit ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BESIM KAMBERI” P.F.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procesure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)